

VENDIM
Nr. 293, datë 10.11.2022

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“ALBSOLAR” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK “ALBSOLAR PV PARK 1”, ME
KAPACITET TË INSTALUAR 2 mw**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1 germa “a”, nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.11.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1918/10 prot., datë 8.11.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘Albsolar’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik ‘Albsolar PV Park 1’, me kapacitet të instaluar 2 mw”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Albsolar” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1874 prot., datë 8.10.2022, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Albsolar PV Park 1”, me kapacitet të instaluar 2 mw.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); shtojcën 1, shtojcën 1A dhe shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (aneksi A). Aplikuesi ka kryer për llogari të ERE-s pagesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, referuar aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “Albsolar” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9, të rregullores: për pikën 1.2, gjerat “a” dhe “d”; për pikën 1.3, gjerat “a”, “b” dhe “c”, për pikën 2.1, gjerat “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.

- Nga ky aplikim rezulton se mungon dokumentacioni si vijon:

- Neni 9, “Formati dhe dokumentacioni për aplikim”

- Pika 1, “Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë”

- Pika 1.1 Aplikuesi ka depozituar të nënshkruar dhe vulosur formatin e aplikimit, sipas rregullores së vjetër ndaj në të tilla rrethana në vijim duhet ta përcjellë sipas shtojcës 1, gjerat “a”, “b”, “c”, që është aktualisht në fuqi.

- Pika 1.2 “Dokumentacioni juridik dhe administrativ”:

- Germa “b”: Shoqëria duhet të përcjellë në ERE vërtetimin e gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti) edhe për shoqërinë “Albsolar” sh.p.k.

- Germa “c”: Shoqëria duhet të përcjellë të nënshkruar dhe vulosur nga administratori strukturën organizative të saj dhe të bëjë me dije, se cila pjesë e strukturës do të jetë në funksion të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike.

Pika 2, “Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës”

- Pika 2.1 Për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë, gjithashtu:

- Germa “a”: Në vijim shoqëria duhet të përcjellë të dhënat teknike për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, sipas shtojcës 2 të rregullores së licencimit, si dhe të bëjë me dije nëse ka filluar punimet apo fazën në të cilën ndodhen, duke qenë se ka deklaruar se data e fillimit të operimit do të jetë 30.12.2022. Po ashtu duhet të paraqesë në ERE dokumentacionin teknik mbi të cilin bazon deklaratën e saj për jetëgjatësinë prej 49 vjetësh të centralit fotovoltaiik, pasi nga rastet analoge të mëhershme, ka rezultuar se jetëgjatësia e një centrali fotovoltaiik, teknikisht nuk mund të jetë më tepër se 25 vjet.

- Bazuar në aktet e përfaqësimit dhe në deklaratën e vetë shoqërive, vlerësohet e nevojshme që t’i drejtohem edhe MIE-s me një shkresë ku t’i kërkohet informacion në lidhje me shoqërinë që do të operojë centralin fotovoltaiik “Albsolar Pv Park 1”, me kapacitet të instaluar 2 mw.

- Në lidhje me dokumentacionin e konstatuar të munguar, do të njoftohet shoqëria ta përcjellë atë brenda afateve të përcaktuara nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Albsolar” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik “Albsolar Pv Park 1”, me kapacitet të instaluar 2 mw.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti